



MË SHUMË INSPEKTIME APO MË SHUMË INSPEKTORË?!

Punim diskutues



Instituti Demokratik I Kosovës është degë e
Transparency International për Kosovë

Misioni i KDI-së është mbështetja e zhvillimit të demokracisë pjesëmarrëse dhe luftës kundër korrupsion përmes promovimit të transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në të gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë

PËRMBAJTJA

6
HYRJE

7-9
1. PROBLEMET NË SEKTORIN E PUNËS

10-11
2. ROLI I INSPEKTORIATIT TË PUNËS NË MBROJTJEN E TË DREJTAVE,
SHËNDETIT DHE SIGURISË NË PUNË

12
3. (S)A PO MBRON
INSPEKTORIATI TË DREJTAT
E PUNËTORËVE?

13-15
4. MË SHUMË INSPEKTIVE APO MË SHUMË INSPEKTORË?

COPYRIGHT © 2021. Kosova Democratic Institute (KDI). Institutit Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, 239
10000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org

Autor: Verolinda Berisha

HYRJE

Që nga viti 2015, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) përmes Qendrës për Avokim dhe Ndhimë Juridike Falas, ka ofruar ndihmë juridike për 3700 qytetarë të cilët kanë raportuar (si të vetëm apo si grupe) mbi 440 raste të ndryshme të korrupsionit, në cilësinë e viktimave apo dëshmitarëve. Një numër i konsiderueshëm i rasteve të raportuara lidhen me shkeljen e të drejtave në vendin e punës, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik.

Puna e tejzgatur, puna pa orar të caktuar, shpëputja e njëanshme e kontratës pa paralajmërim, mungesa e sigurisë fizike në punë, mungesa e kushteve minimale të punës dhe lëndimet në vendin e punës, moskompensimi për punë gjatë vikendeve apo festave, vonesat në pagesën e pagave, mospagesa e kontributeve pensionale apo pagesa me para në dorë, janë shkeljet më të shpeshta, të cilat pothuajse janë "normalizuar" për punëtorët e sektorit privat. Për dallim, shkeljet në sektorin publik janë kryesisht të lidhura parregullsitë në konkurse publike, mos-transparencën, punësimin mbi baza partiake dhe nepotizmin.

Puna shumëvjeçare dhe e drejtpërdrejtë me qytetarët shpërfaqë disa fakte të rëndësishme – **mosnjohjen e të punësuarve me të drejtat bazike** që garantohen me Ligjin e Punës, **mungesën e informacionit se ku duhet drejtuar ankesat** për shkeljet e të drejtave të tyre apo **afatet kohore** brenda së cilave ata mund të ankohen.

Në qershor të këtij viti, KDI ka plasuar edhe platformën për raportim online¹ e cila mundëson që rastet e korrupsionit të raportohen edhe në mënyrë elektronike dhe anonime. Në fakt, shumica e raportimeve anonime, gjatë periudhës së pandemisë kanë qenë kryesisht të lidhura me shkeljen e të drejtave të punës, sidomos në sektorin privat. Vetë natyra e raportimit tregon për një gjendje të rëndë të punëtorëve në sektorin privat. Ata hezitojnë të shpërfaqin identitetin e tyre apo të punëdhënësve të tyre, duke u kufizuar vetëm në natyrën e shkeljes dhe sektorin ku ata punojnë.

1 Platforma për raportim online mund të qaset përmes këtij linku <https://raporto.kdi-kosova.org/#/>



Puna shumëvjeçare dhe e drejtpërdrejtë me qytetarët shpërfaqë disa fakte të rëndësishme – **mosnjohjen e të punësuarve me të drejtat bazike** që garantohen me Ligjin e Punës, **mungesën e informacionit se ku duhet drejtuar ankesat** për shkeljet e të drejtave të tyre apo **afatet kohore** brenda së cilave ata mund të ankohen.

Raportimet po ashtu shpërfaqin joefikasitetin e Inspektoratit të Punës së Kosovës në raport me ankesat e palëve. Përkundër adresimit të ankesave të shumta tek Inspektorati i Punës, përgjigjet e këtij të fundit kanë munguar në masë të madhe. Kjo përbën shqetësim, pasi Inspektorati i Punës është trup i krijuar për të mbikëqyrur zbatimin e Ligjit të Punës, respektivisht të drejtat e punëtorëve. Gjithashtu shumë qytetarë gjatë raportimit të tyre kanë shprehur mungesën e besimit se ky institucion do të mund të mbrojë të drejtat e tyre të punës.

Bazuar në analizën e shkeljeve të raportuara gjatë vitit 2020/2021 dhe rolin e përgjegjësitë e Inspektoratit të Punës, **ky punim diskutues ka për qëllim të ofrojë perspektiva** se si do të mund të përmirësohej situata me zbatimin e të drejtave të punës, përkatësisht Ligjit të Punës, Ligjit për Shëndet dhe Siguri në Punë dhe akteve tjera nënligjore që derivojnë nga këto ligje.

1. PROBLEMET NË SEKTORIN E PUNËS

Problemet kronike me të cilat ballafaqohet sektori i punës janë:

Informaliteti. Sipas një studimi të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, lufta në Kosovë dhe ndërtimi i gjithçkaje nga e para, ndikoi në nivelin e lartë të informalitetit në sektorin e punësimit, i cili manifestohet përmes punonjësve të paregjistruar ose të padeklaruar, si dhe pagave të pa raportuara ose 'në zarf'.²

Vlerësohet se informaliteti në Kosovë përbën rreth 1/3-tën e totalit të punëtorëve në tregun e punës. Por, kur informaliteti përcaktohet më ngushtë, pra si përqindje e punonjësve me pagë që nuk kanë kontratë pune, vlerësohet se rreth 15% e punëtorëve në Kosovë punojnë në sektorin informal. Në anën tjetër, sipas Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat **më tepër se 60% e punëtorëve të sektorit privat në Kosovë janë pa kontrata pune**³. Ndërkohë që Organizata Ndërkombëtare e Punës - ILO (2018) vlerëson se më shumë se 60 përqind e popullsisë së punësuar në botë janë në ekonominë joformale, shumica e tyre në vendet në zhvillim⁴. Edhe të dhënat e sondazhit të administruar nga Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS),⁵ tregojnë që 57.5% e bizneseve të anketuara raportojnë se paguajnë punonjësit e tyre tërësisht me para në dorë, ndërsa 15% të kompanive në mostër raportojnë për kompensim të punonjësve pjesërisht me para në dorë.⁶



15%
e punëtorëve në Kosovë punojnë në sektorin informal



60%
e popullsisë së punësuar në botë janë në ekonominë joformale, shumica e tyre në vendet në zhvillim

60% e punëtorëve të sektorit privat në Kosovë janë pa kontrata pune

2 Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosoves, Analiza e ekonomisë në hije në Kosovë, 2019 http://www.ashak.org/repository/docs/Analiza_e_ekonomise_ne_hije_ne_Kosove_529729.pdf
3 "Mbi 60 përqind e punëtorëve të sektorit privat janë pa kontrata pune", 2021 <https://sinjali.com/mbi-60-per-qind-e-punetoreve-te-sektorit-privat-jane-pa-kontrata-pune/>
4 Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosoves, Analiza e ekonomisë në hije në Kosovë, 2019 http://www.ashak.org/repository/docs/Analiza_e_ekonomise_ne_hije_ne_Kosove_529729.pdf
5 Iniciativa Kosovare për Stabilitet, Raporti final i monitorimit për nivelin e zbatimit të Ligjit të Punës <https://iksweb.org/wp-content/uploads/2020/10/report-la-bour-law-implementation-FINAL-Shqip.pdf> "Komponenti sasior i hulumtimit përfshin anketën me 80 biznese në mbarë Kosovën. Bizneset në mostër përfaqësojnë një përbërje të ngjashme me bizneset në realitetin në Kosovë, me 54% të tyre të angazhuar në shërbime, 30% në tregti me pakicë dhe 16% në aktivëpuese produese"
6 Ibid



Ndërkohë që edhe të dhënat nga raporti vjetor i punës për vitin 2020 i Inspektoratit të Punës, tregojnë që shkeljet më të shpeshta ligjore të punëdhënësve në raport me punëtorët i referohen mos lidhjes së kontratës së punës. Gjatë vitit 2020 Inspektorati i Punës kishte inspektuar në total 25,725 punëtorë prej të cilëve **460 ishin pa kontrata pune**, 316 e të cilëve ishin burra dhe 144 gra. Ndërkohë sipas OJQ-së Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) Gratë në Kosovë punojnë pa kontrata shumë më shumë se sa burrat.⁷

Edhe raportimet e të punësuarve nga sektori privat në KDI (Qendrën për Avokim dhe Ndihmë Juridike falas - ALAC) mbështesin faktin që jo të gjithë punëdhënësit e tyre ofrojnë kontrata pune, ndërkohë që ata nuk këmbëngulin t'i kenë ato nga frika se kjo mund të çojë në largimin e tyre nga puna ose në veprime tjera që mund t'i dëmtojnë ata. Në fakt, shumë prej tyre tregojnë që ata kanë punuar me vite pa

kontratë pune. Mungesa e informimit dhe frika nga pasojat kanë ndikuar kështu në rritjen e informalitetit dhe shkeljeve ligjore.

Në shkeljen e të drejtave të punëtorëve gjatë viti 2020 në Kosovë mbi të gjitha ka ndikuar pandemia COVID 19, e cila kishte prekur të gjithë botën. Për shkak të mbylljes totale shumë të punësuar kishin humbur vendin e punës, derisa të tjerët përjetuan shkelje të dispozitave ligjore që garantohen me Ligjin e Punës. Me fillimin e pandemisë, KDI ka pranuar 19 raportime për shkeljet e të drejtave të punëtorëve të një mediumi, dy prej të cilëve shtatzëna (gazetar, redaktor, staf tjetër) u janë shkelur të drejtat elementare duke u përjashtuar nga puna pa asnjë paralajmërim dhe në kundërshtim me Ligjin e Punës.⁸

Siguria dhe shëndeti në punë. Bazuar në raportin vjetor të Inspektoratit të Punës gjatë vitit 2020 në Kosovë janë regjistruar **176 aksidente në vendin e punës, 16 prej të cilave kanë përfunduar me vdekje.** Po ashtu, 105 aksidente kanë qenë me lëndime të lehta dhe 55 me lëndime të rënda.⁹ Mungesa e sigurisë në punë, me theks në sektorin e ndërtimit, nuk përbën rrezik vetëm për punëtorët që punojnë në atë vend të punës, në shumë raste rrezikon edhe qytetarët të cilët banojnë ose kalojnë afër.



+ **176**
aksidente në
vandin e punës

xx **16**
prej të cilave
kanë përfunduar
me vdekje.

105
aksidente kanë
qenë me lëndime të
lehta

55
me lëndime
të rënda.

⁷ <https://www.facebook.com/IniciativaKosovareperStabilitet/posts/4920292454651046>

⁸ Perfitimet e punëtorëve nga pakoja emergjente-ALAC përgjate pandemisë, 2020 <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2020/05/89-ALAC-pergjate-Pandemise-COVID-19-ALB-01.pdf>

⁹ Inspektorati i Punës, Raporti Vjetor 2020, fq. 6 <https://ip.rks-gov.net/wp-content/uploads/RAP-NARRATIV-I-IP-se-2020-002-compressed.pdf>



Sipas Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë, punëdhënësi është përgjegjës për të siguruar kushte të sigurta dhe shëndetshme të punës. Ligji kërkon që punëdhënësi të caktojë një ose më shumë të punësuar për të mbikëqyrë sigurinë dhe shëndetin në punë.¹⁰ Për më tepër, ligji kërkon nga punëdhënësit që të trajnojnë punonjës për të kryer evakuimin, shpëtimin, fikjen e zjarrit dhe dhënin e ndihmës së parë.¹¹ Përkundër këtyre obligimeve ligjore, sipas anketës së realizuar nga IKS, 76.3 % e kompanive raportojnë se nuk kanë staf të trajnuar për shëndetin dhe sigurinë në punë, dhe 63.8% e kompanive në mostër raportojnë se nuk kanë asnjë punonjës të certifikuar as në ofrimin e ndihmës së parë ose në reagimin emergjent.¹²

Shkeljet e dispozitave të Ligjit të Punës

a) Puna me orar të tejjgjatur është një nga shkeljet më të shpeshta që raportohen në KDI. Në sektorin privat është pothuajse "normale" të punohet deri në 10 orë në ditë ose gjatë vikendeve, por për këtë të mos aplikohet asnjë formë e kompensimit. Edhe pse Ligji i Punës rregullon çështjen e orarit të rregullt të punës dhe kompensimin për punën që kryhet jashtë këtij orari, në praktikë këto dispozita ligjore nuk zbatohen. Përveç që cilësohet si shkelje e të drejtave të punës, puna me orar të zgjatur ka ndikim edhe në sigurinë e punëtorëve në vend të punës.

Sipas një raportimi anonim, orari i rregullt i punës nuk respektohet fare nga kompanitë e taksive. Shumë punëtorë të këtyre kompanive punojnë deri në 15 orë në ditë pa ndërprerje, gjatë vikendeve, ndërkohë që kjo punë nuk kompensohet. Një orar i tillë ndikon në lodhjen jo vetëm fizike por edhe psikike të punëtorit e cila shkakton mungesë koncentrimi gjatë vozitjes, rrjedhimisht përbën rrezik për sigurinë e përgjithshme në komunikacion. Inspektorati i Punës në raportin vjetor të vitit 2020 nuk trajton siç duhet respektimin e orarit të punës. Megjithatë raporti i punës i IP

¹⁰ Ibid, Neni 9

¹¹ Ibid, Neni 10

¹² Iniciativa Kosovare per Stabilitet, Raporti final i monitorimit per nivelin e zbatimit te Ligjit te Punes <https://iksweb.org/wp-content/uploads/2020/10/report-labour-law-implementation-FINAL-Shqip.pdf>

¹³ Inspektorati i Punës, Raporti Vjetor 2020 <https://ip.rks-gov.net/wp-content/uploads/RAP-NARRATIV-I-IP-se-2020-002-compressed.pdf>

¹⁴ Ibid, Neni 70,71 dhe 72

¹⁵ Inspektorati i Punës, Raporti vjetor 2020 <https://ip.rks-gov.net/wp-content/uploads/RAP-NARRATIV-I-IP-se-2020-002-compressed.pdf>



Sipas një raportimi anonim, orari i rregullt i punës nuk respektohet fare nga kompanitë e taksive. **Shumë punëtorë të këtyre kompanive punojnë deri në 15 orë në ditë pa ndërprerje, gjatë vikendeve, ndërkohë që kjo punë nuk kompensohet.**

për vitin 2020 tregon vetëm për 41 raste kur punëtorët nuk janë kompensuar për orët shtesë të punës.¹³

b) Largimet nga puna pa paralajmërim – fenomeni i shkëputjes së kontratës së punës pa paralajmërim është një nga shkeljet më të shpeshta të raportuara. Sipas Ligjit të Punës punëdhënësi duhet t'a lajmërojë punëmarrësin për shkëputjen e kontratës brenda afatit të përcaktuar me ligji. Punëdhënësi duhet të japë një arsyetim tek punëmarrësi në lidhje me shkaqet e shkëputjes së kontratës, në formë të një vendimi të shkruar dhe të arsyetuar.¹⁴

c) Cenimi i të drejtës për pushimet vjetore – Ndonëse e garantuar me ligjin e punës, e drejta për pushim vjetor me pagesë, cenohet në masë të konsiderueshme për punëtorët në sektorin privat. Gjatë vitit 2020, IP ka evidentuar vetëm 110 raste kur të punësuarve nuk iu është realizuar e drejta në pushim vjetor, nuk u është paguar pushimi ose u janë shkurtuar ditët e pushimit.¹⁵



2. ROLI I INSPEKTORIATIT TË PUNËS NË MBROJTJEN E TË DREJTAVE, SHËNDETIT DHE SIGURISË NË PUNË

Inspektorati i Punës i Kosovës, funksionon në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për të siguruar respektimin e të drejtave të punëtorëve dhe kushteve të

punës. Ekzistimi dhe funksionimi i një mekanizmi të tillë parashihet me norma dhe standarde ndërkombëtare. Organizata Ndërkombëtare e Punës (e njohur si ILO) ndër

të tjera ka miratuar dy konventa, nr. 81¹⁶ dhe nr. 129, për përcaktimin e standardeve e mbrojtës së punëtorëve prej Inspektoratit të Punës dhe për të fuqizuar rolin e tij.¹⁷ Sipas Ligjit për Inspektoratin e Punës¹⁸ funksioni kryesor i Inspektoratit është të "mbikëqyrë zbatimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore ne lëmin e punës në mënyrë gjithë përfshirëse duke përfshinë marrëdhëniet e punës, sigurinë në punë, mbrojtjen e shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës".

Inspektorati i Punës siguron respektimin e Ligji të Punës dhe Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë si ligjet bazike, por edhe të akteve nënligjore të cilat sigurojnë mbrojtje të të drejtave dhe sigurisë së punëtorëve në vendin e punës. Kjo bëhet përmes ekzaminimeve, kontrolleve e inspektimeve. Ligji për Inspektoratin e Punës rregullon autorizimet të cilat inspektorët e punës kanë gjatë inspektimeve. Inspektori i punës është i autorizuar që:

- të hyjë lirisht në çdo vend pune dhe në seli të punëdhënësit në kuadër të kompetencave të inspektimit të tyre pa paralajmërim,
- të bëjë kontrollimin e të gjitha librave dhe dokumenteve të cilat duhet t'i mbajë punëdhënësi siç është përcaktuar me ligjin e punës,
- të marrë ekstraktet nga regjistrat dhe dokumentet,
- të kërkojë nga punëdhënësi dërgimin e shënimeve apo dokumenteve të cilat janë kërkuar,
- të marrë mostra nga materialet apo substancat e përdorura me qëllim të analizave dhe njoftimin e punëdhënësit apo përfaqësuesit të tij lidhur me këtë.

Ligji po ashtu përcakton që inspektorët, në rast të kualifikimit të shkeljeve mund të marrin këto masa:

- Japin vërejtje me shkrim për parregullsitë e konstatuara dhe caktojnë afatin brenda të cilit duhet të eliminohen këto parregullsi¹⁹,
- Shqiptojnë gjoba²⁰,
- Urdhërojnë ndërmarrjen e masave të menjëhershme duke përfshirë edhe ndalimin e punës aty ku ka fakte të

pamohueshme dhe të verifikuara se kushtet në vendin e punës shfaqin rrezik të drejtpërdrejtë dhe serioz për shëndetin apo sigurinë e punëtorëve dhe personave të tretë si dhe në rastet kur punëdhënësi nuk posedon leje të punës.²¹

- Pranojnë dhe trajtojnë ankesa nga të punësuarit.²²

Por ligji nuk përcakton llojet e inspektimeve të cilat kryhen dhe rrethanat në të cilat kryhen këto inspektime. Llojet e inspektimeve janë të ditura vetëm në raportet vjetore të Inspektoratit të Punës, në të cilat kategorizohen si të planifikuara, të përsëritura, të jashtëzakonshme, në bashkëpunim me institucionet tjera mbikëqyrëse, inspektimet lidhur me luftimin e pandemisë dhe inspektimet sipas ankesave të palëve. Mungesa e përcaktimit të llojit të inspektimeve është problematike sepse inspektorët mund të bëjnë inspektime të ndryshme dhe pastaj t'i kategorizojnë në bazë të nevojave të tyre në raportim.²³

Ligji po ashtu nuk përcakton lartësinë e gjobave të cilat mund të shqiptohen, në cilat raste shqiptohen gjobat dhe në cilat raste jepen vërejtje me shkrim. Në raportin vjetor të IP përmendet vetëm numri i gjobave dhe vërejtjeve të cilat janë shqiptuar gjatë vitit 2020, mirëpo nuk tregohen arsyet dhe lartësia e gjobave të shqiptuara.

¹⁶ ILO, Konventa nr.81 <https://ip.rks-gov.net/wp-content/uploads/Konventa-e-ILO-nr-81.pdf>

¹⁷ "Labour Inspection: What It Is and What It Does", International Labour Office, https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_dialogue/---lab_admin/documents/instructionalmaterial/wcms_141403.pdf

¹⁸ Ligji për Inspektoratin e Punës <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2581>

¹⁹ Ibid, Neni 5 paragrafi 5 shkronja D

²⁰ Ibid, Neni 5, paragrafi 5 shkronja C e ndryshuar me nenin 5 të ligjit Ligji Nr. 03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës Nr. 2002/9

²¹ Ibid, Neni 5 paragrafi 5 shkronja D e ndryshuar me nenin 5 të ligjit Ligji Nr. 03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës Nr. 2002/9

²² Ashtu siç është rregulluar me Ligjin e Punës dhe Ligji për Inspektoratin e Punës

²³ Qendra për Politikë dhe Avokim, Analizë e Ligjit për Inspektoratin e Punës në Kosovë, 2020 <file:///C:/Users/KDI/Desktop/Policy%20brief/analize%20per%20projektiligjin%20per%20IP%20QPA.pdf>



3. (S)A PO MBRON INSPEKTORIATI TË DREJTAT E PUNËTORËVE?

Shkeljet e të drejtave të punëtorëve dhe mosrespektimi i akteve ligjore dhe nënligjore vazhdojnë të mbesin njëri prej problemeve të vazhdueshme në Kosovë me të cilën ballafaqohen të punësuarit, sidomos ata në sektorin privat.

Shkeljet e të drejtave të punëtorëve janë të vazhdueshme, të përsëritshme dhe në numër të lartë. Sipas raportit vjetor të punës së IP për vitin 2020, numri i përgjithshëm i inspektorëve të punës për gjithë territorin e Kosovës ishte 39, prej të cilëve vetëm 33 ishin aktivë. Numri i përgjithshëm i inspektimeve të realizuara për vitin 2020 ishte **8059** (prej tyre 3832 inspektime të planifikuara, 1555 të përsëritura, 169 të jashtëzakonshme, 66 inspektime në bashkëpunim me institucionet tjera mbikëqyrëse dhe 2437 inspektime lidhur me luftimin e pandemisë COVID-19), përjashtuar 10447 inspektimet që janë bërë sipas ankesave të palëve (9801 ankesa nga sektori publik dhe 646 nga sektori privat)²⁴. Këto inspektime kanë trajtuar në total **25,725 punëtorë**. Bazuar në numrin e inspektimeve (ex officio) një inspektor aktiv gjatë 2020-tës ka realizuar mesatarisht 22 inspektime në muaj, respektivisht 1 inspektim në ditë ndërsa bashkë me inspektimet sipas ankesave të palëve atëherë një inspektor ka kryer afër 47 inspektime në muaj²⁵.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për 2020, fuqia punëtore numëron 468,451 persona, prej të cilëve **347,071 janë të punësuar në sektorin publik dhe atë privat**²⁶. Sektori privat llogaritet punëdhënësi më i madh në vend me mbi 220 mijë punëtorë²⁷, por Sindikata e pavarur e sektorit privat argumenton se 60% e të punësuarve në këtë sektor punojnë pa kontrata²⁸.

24 Raporti Vjetor 2020 I IP, <https://ip.rks-gov.net/wp-content/uploads/RAP-NARRATIV-I-IP-se-2020-002-compressed.pdf>
 25 Ibid, fq.6
 26 Agjencia e Statistikave të Kosovës, Fuqia Punëtore 2020 <https://ask.rks-gov.net/media/6125/anketa-e-fuqis%C3%AB-pun%C3%ABtore-afp-2020.pdf>
 27 Radio Evropa e Lire, <https://www.evropaelire.org/a/punetoret-sektori-privat-kosove/31332279.html>
 28 Gazeta monitor, <https://www.monitor.al/kerkohet-rritja-e-pages-minimale-mbi-60-e-punetoreve-ne-kosove-jane-pa-kontrata-pune/>

4. MË SHUMË INSPEKTIME APO MË SHUMË INSPEKTORË?

Nevoja për rritjen e numrit të inspektorëve të punës është argumentuar vazhdimisht nga organizatat e shoqërisë civile, sindikatat e punëtorëve të sektorit privat, punëtorët në Kosovë dhe nga vetë Inspektorati i Punës.²⁹ Kjo për shkak se mungesa e inspektorëve është konsideruar si një prej arsyeve kryesore që ka prodhuar një gjendje të rëndë në raport me punëtorët, sidomos atyre në të punësuar në sektorin privat. Duke u thirrur në rastet e shpeshta të shkeljeve të drejtave të punës që raportoheshin në KDI, dhe duke analizuar shkaqet e shkeljeve, KDI vazhdimisht u kishte kërkuar institucioneve vendim-marrëse (Qeverisë e Kuvendit) të adaptonin politika buxhetore që do të mbështesnin rritjen e numrit të inspektorëve të punës³⁰, ndërsa nga Inspektorati i Punës kishte kërkuar transparencë dhe efikasitet të shtuar në trajtimin e rasteve.

Kërkesat për rritje të numrit të inspektorëve të specializuar në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë u ngritën edhe nga OJQ tjera si QPA.³¹ Për më tepër, numri i pamjaftueshëm i inspektorëve të Punës është njeri prej problemeve që pamundëson funksionimin efektiv të inspektoratit apo mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të Punës dhe legjislacionit tjetër relevant në marrëdhëniet e punës.³²

Problemi i mungesës së inspektorëve të punës është ngritur edhe nga vetë Inspektorati i Punës, sipas të cilit pengesa

kryesore për ushtrimin e funksionit të tyre gjatë vitit 2020 ishte pikërisht mungesa e inspektorëve, e përcjellur edhe me probleme të tjera si ato teknike, logjistike, mungesa e zyreve adekuate për inspektorët, pengesa këto të cilat ndikojnë direkt në realizimin e suksesshëm të përgjegjësisë të tyre ligjore³³.

Sipas IP numri aktual i inspektorëve të punës nuk është i mjaftueshëm për inspektimin e subjekteve aktive në Kosovë gjatë një viti. Sipas IP subjektet punuese aktive (firma, kompani ose organizata të cilat punësojnë në bazë të Ligjit të Punës), duhet të inspektohen të paktën një herë në vit³⁴, dhe momentalisht në Kosovë janë gjithsej 50,000 subjekte aktive. Sipas IP "numri i inspektorëve karshi numrit të subjekteve punuese është tejet i vogël" duke pamundësuar inspektimin e plotë të subjekteve aktive.³⁵ Mosinspektimi i subjekteve punuese favorizon shkallën e informalitetit, shkeljeve të të drejtave të punës dhe cenimin sigurisë dhe shëndetit në punë.

Nevoja e rritjes së numrit të inspektorëve përbën një nga zotimet e Qeverisë aktuale Kurti II. Në programin qeverisës, mbrojtja e të drejtave të punëtorëve dhe përmirësimi i kushteve të punës, si dhe rritja e numrit të inspektorëve të punës është vendosur si prioritet.³⁶ Edhe gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2021,

29 Koha, Kërkohet rritje e numrit të inspektorëve <https://www.koha.net/arberi/271583/kerkohet-rritje-e-numrit-te-inspektoreve/>
 Kërkohet shtimi i numrit të inspektorëve dhe rritja e stafit administrativ, Kryetari i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, <https://gazetaenigma.com/kerkohet-shtimi-i-numrit-te-inspektoreve-dhe-rritja-e-stafit-administrativ/>
 Sylejman Klinaku, anëtar i Këshillit Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë, <https://ekonomiaonline.com/nacionale/kerkohet-rritja-e-numrit-te-inspektor-eve-te-punes/>
 30 KDI, Punëtorët që s'kanë të drejta, <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2018/01/155-unetoret-ge-s-kane-te-drejta-2017-alb.pdf>
 31 Qendra për Politika dhe Avokim, Analizë e Ligjit për Inspektoratin e Punës në Kosovë, 2020 <file:///C:/Users/KDI/Desktop/Policy%20brief/analize%20per%20projektiqin%20per%20IP%20QPA.pdf>
 32 Iniciativa Kosovare për Stabilitet, Gjendja e Zbatimit të Ligjit të Punës në Kosovë, 2020 <https://iksweb.org/wp-content/uploads/2020/10/report-labour-law-implementation-FINAL-Shqip.pdf>
 33 Raporti Vjetor i IP për 2020
 34 MPMS, Plani Strategjik për Inspektoratin e Punës 2017-2021 fq.9 <https://ip.rks-gov.net/wp-content/uploads/Plani-zhvillimor-strategjik-i-IP-2017-2021.pdf>
 35 Raporti Vjetor 2020, Inspektorati i Punës, fq. 6
 36 Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025, fq.11 <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/05/Programi-i-Qeverise-se-Kosoves-2021-2025.pdf>



subjekti Lëvizja Vetëvendosje ka premtuar pesëfishimin e numrit të inspektorëve të punës.³⁷

Më 11.08.2021, Qeveria e Kosovës kishte miratuar **Planin e Veprimit (ERA II) për zbatimin e fazës së dytë të prioriteteve politike të dakorduara mes Kosovës dhe BE.**³⁸ Një nga prioritetet në këtë plan ishte edhe punësimi, respektivisht përmirësimi i shëndetit dhe sigurisë në punë. Për më tepër, një ndër masat e parapara në këtë plan ishte edhe **rritja e numrit të inspektorëve të punës për 20 inspektor**, realizimi i së cilës pritej nga tremujori i tretë i vitit 2021 deri tek tremujori i katërt i vitit 2022.³⁹

Sidoqoftë, përkundër këtyre planifikimeve, buxheti i Inspektoratit të Punës në kuadër të projekt-buxhetit për 2022⁴⁰, i miratuar nga Qeveria e Kosovës më 29.10.2021 është paraparë të jetë **790,632 euro**, i cili në fakt është më i ulët se buxheti i IP për 2021 i cili ishte 795,126 euro.⁴¹ Po ashtu në projektbuxhetin e vitit 2022 numri i të punësuarve në Inspektoriatin e Punës nuk parashihet të rritet. Kjo tregon se zotimet e vendosura në Planin e Veprimit ERA II, (i cili u miratua edhe nga Kuvendi më 4 tetor 2021) nuk janë reflektuar në projekt-buxhetin e aprovuar nga Qeveria e Kosovës.

Koeficienti i pagës së inspektorëve të punës, është 8, që nënkupton që mesatarisht paga e tyre mujore sillet midis 480-500 euro.⁴² Nëse zotimet në planin ERA II për rritjen e numrit të inspektorëve për 20 sosh do të realizoheshin, buxheti për pagat e inspektorëve do të duhej të rritej për 120,000 euro në vit, gjë që nuk është planifikuar.

Cila do të ishte kostoja opurtune e shtimit të 20 inspektorëve nga Qeveria?

Sektori privat llogaritet të jetë punëdhënësi kryesor me 220,000 të punësuar, ndërkohë që Sindikata e Pavarur e Sektorit Privat paralajmëron që 60% e të punësuarve në këtë sektor punojnë pa kontrata pune. Nëse këta 132,000 punëtorë (ose 60%) paguhen mesatarisht 350 euro në muaj⁴³, por vazhdojnë të mos figurojnë si punëtorë të rregullt me kontrata pune, atëherë shteti nuk do të mund të mbledh mjaftueshëm të hyra nga tatimi në të ardhura personale, të cilat përllogariten të jenë në vlerën 8-10% të pagës së tyre mujore⁴⁴.

Hipotetkisht për 132,000 punëtorë pa kontrata pune, të cilët marrin pagë mesatare mujore 350 euro, buxheti i shtetit do të varfërohej për përafërsisht 4,620,000 euro në muaj, i llogaritur si 10% e tatimit në të ardhura personale.

Në anën tjetër rritja e numrit të inspektorëve të punës vetëm për 20, buxhetit të Kosovës për një vit do t'i kushtonte 120,000 euro, kosto kjo e llogaritur mbi bazën e pagës mesatare të një inspektori të punës që është 500 euro në muaj.

37 "Murati paralajmëron pesëfishim të numrit të inspektorëve të Punës" <https://www.koha.net/arberi/270766/murati-kete-vit-fokusi-do-te-jete-per-rikthim-ekonomik-dhe-kthim-ne-vende-pune/>
 38 Vendimi i Qeverise 2021 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=45816>
 39 Plani i Veprimit ERA II, 3.3b.
 40 Qeveria e Kosovës, Projektligjin për ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/BB5A3463-4BFE-4007-8C4D-E44BEE7A6B87.pdf?fbclid=IwAR1rkzBXpof2uMSfCQb5_x3GUTFMXZZv48IvcqyJxs4Nzm2uFxB2IT2rIFy
 41 Ligji mbi ndarjet buxhetore për ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/5EA509E4-2933-4524-BD0F-5466A661486F.pdf>
 42 Konkursi për inspektor pune i shpallur nga Ministria e Punës dhe Mireqenies Sociale <https://ip.rks-gov.net/wp-content/uploads/Konkursi-per-20-inspektor-shqip-dhe-serbisht-pdf>
 43 <https://www.monitor.al/dilema-e-pages-minimale-ne-kosove-2/>
 44 https://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2017/07/LIGJI_NR_05_L-028_P%C3%8BR_TATIMIN_N%C3%8BT_T%C3%8B_ARDHURAT_PERSONALE1.pdf



Inspektorët e punës në Kosovë dhe rajon

Nëse krahasojmë Kosovën me vendet e rajonit (gjithmonë duke konsideruar dallimet në shkallën e punësimit dhe zhvillimit ekonomik) shohim se Kosova ka numrin më të ulët të inspektorëve të punës. Sipas raportit vjetor 2020

Inspektorati i Punës në Shqipëri funksionon me një staf prej 95 inspektorësh në terren. Në Maqedoninë e Veriut, bazuar në raportin gjashtëmujor 2021 të Inspektoratit Shtetëror të Punës, momentalisht janë 107 inspektorë.⁴⁵ Inspektorati i Punës në Serbi si organ administrativ funksionon me 218 inspektor pune.⁴⁶ Në Malin e Zi janë në total 40 inspektor (30 për çështje të kontratave dhe 10 për siguri në punë).⁴⁷

	Nr i përgjithshëm i i të punësuarve 2020 (dy sektorët)	Nr i Inspektorëve të punës - 2020	Numri i inspektorëve në raport me të punësuarit sipas ILO
Kosova	347,071	39	35
Shqipëria	1,231,453 ⁴⁸	95	123
Mali i Zi	176,693 ⁴⁹	40	18
Serbia	2,215,475 ⁵⁰	218	222
Maqedonia	759,445 ⁵¹	107	76

Cilat janë standardet ndërkombëtare?

Sipas standardeve të përcaktuara nga Organizata Ndërkombëtare të Punës (ILO) për çdo 10,000 të punësuar duhet të ketë një inspektor pune.⁵² Duke u nisur nga shifrat zyrtare të të punësuarve në Kosovë në vitin 2020 (347,071), Kosova do të duhej të kishte së paku 35 inspektorë pune

në dispozicion për të përmbushur standardet e ILO. Me 39 inspektorë të punësuar në IP, Kosova në parim përmbush normat ndërkombëtare për numrin e inspektorëve, mirëpo numri i inspektiveve apo sanksioneve/gjobave mbetet jashtëzakonisht i ulët, përkundër shkeljeve enorme të të drejtave të punës dhe shkallës së lartë të informalitetit.

45 Inspektoriatit Shtetëror i Punës në Maqedoninë e Veriut https://dit.gov.mk/?page_id=549
 46 Raporti Vjetor 2020 i Inspektoriatit të Punës <https://inspektor.gov.rs/cms/documents/22907/0>
 47 Labor Inspection in Montenegro <http://www.balkanoshconference.org/wp-content/uploads/2018/11/Zlatko-Popovi%C4%87-Labour-Inspection-in-Montenegro.pdf>
 48 <http://www.instat.gov.al/media/8132/atfp-t4-2020.pdf>
 49 <https://www.monstat.org/uploads/files/Bilten/2021/1/3.pdf>
 50 <https://publikacije.stat.gov.rs/G2021/PdfE/G20211014.pdf>
 51 https://www.stat.gov.mk/Default_al.aspx
 52 International Labor Organization https://www.ilo.org/ilostat-files/Documents/description_LAI_EN.pdf



Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) / Transparency International Kosova (TIK), beson në një Kosovë ku qeveria, bizneset, shoqëria civile dhe jeta e përditshme e qytetarëve janë të lira nga korrupsioni. KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë pjesëmarrëse dhe luftën kundër korrupsionit përmes promovimit të transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në të gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni www.kdi-kosova.org

Me përkrahjen financiare nga Ministria Federale e Punëve të Jashtme e Gjermanisë



RAPORTO KORRUPSIONIN në numrin pa pagesë

0800 77777 ose online në

<https://raporto.kdi-kosova.org>

